

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Lorista® 50 mg film tableta të mbështjellura
Lorista® 100 mg film tableta të mbështjellura

losartan kalium

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërën me kujdes para se të filloni ta merrni këtë bar.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, pyeteni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ua jepni ate të tjerëve. Mund t'u bëjë dëm atyre edhe nëse simptomat i kanë të njejta me tuajat.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit tuaj.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Lorista dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Lorista
3. Si të merrni Lorista
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Lorista
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË LORISTA DHE PËR SE PËRDORET

Losartan (Lorista) i përket një grupi të barnave të njohur si “antagonistët e receptorëve të angiotensinës II”. Angiotensin II është një substancë e prodhuar në organizëm e cila lidhet për receptorët në enët e gjakut, duke shkaktuar ngushtimin e tyre. Kjo rezulton në një rritje të tensionit të gjakut. Losartan pengon lidhjen e angiotensin II për këta receptorë, duke shkaktuar relaksimin e enëve të gjakut që rezulton në uljen e tensionit të gjakut. Losartan ngadalëson uljen e funksionit të veshkave në pacientët me tension të lartë dhe diabet të tipit 2.

Lorista përdoret për:

- trajtimin e tensionit të lartë të gjakut (hipertensionit) tek të rriturit, fëmijët dhe adoleshentët e moshës prej 6–18 vjet.
- të mbrojtur veshkat te pacientët me hypertension me diabet të tipi 2 me prova laboratorike me dëmtime të funksionit të veshkave dhe proteinuri $\geq 0,5$ g në ditë (një gjendje në të cilën urina përmban një sasi të parregullt të proteinave).
- trajtimin e pacientëve me insuficiencë kronike të zemrës kur terapia me barna të veçantë të quajtur inhibitorët e konvertimit të enzimës angiotensin (ACE inhibitorët, barna të përdorura për të ulur tensionin e lartë të gjakut) nuk konsiderohet e përshtatshme nga mjeku juaj. Nëse insuficienca e zemrës suaj stabilizohet me një ACE inhibitorë, ju nuk duhet të merrni losartan.
- pacientët me tension të lartë dhe me një trashje të ventrikulit të majtë, Lorista ka treguar se ul rrezikun e sulmit (“LIFE indikacioni”).

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



2. PARA SE TË MERRNI LORISTA

Mos merrni Lorista

- nëse jeni alergjik në losartan ose në ndonjë nga përbërësit e tjerë të barit (e dhënë në seksionin 6).
- në qoftë se funksioni i mëlçisë është rëndë, i dëmtuar.
- nëse ju jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë (gjithashtu është mirë që të shmangët marrja e Lorista në shtatzëninë e hershme-shih seksionin Shtatzënia dhe gjdhënia).
- nëse keni diabet ose keni funksion të dëmtuar të veshkave dhe ju jeni trajtuar me një bar që shkakton ulje të presionit të gjakut që përmban aliskiren.

Tregoni kujdes të veçantë me Lorista

Bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se të filloni të përdorni Lorista.

Ju duhet të tregoni mjekut tuaj nëse ju mendoni se jeni (ose mund të bëheni) shtatzënë. Lorista nuk rekomandohet në fillim të shtatzënisë, dhe nuk duhet të merret qoftë se ju jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë, pasi ajo mund të shkaktojë dëmtime serioze për fëmijën tuaj, nëse përdoret në atë fazë (shih pjesën e shtatzënisë).

Është e rëndësishme që ti tregoni mjekut tuaj para se të merrni **Lorista**:

- nëse ju keni pasur një histori të angioedemës (ënjtje të fytyrës, buzëve, fytit, dhe/ose gjuhës) (shih gjithashtu pjesën 4 “Efektet anësore të mundshme”).
- në qoftë se ju vuani nga të vjella apo diarre (barkqitje) e tepruar që çon në një humbje ekstreme të lëngjeve dhe/ose të kripës në organizimin tuaj.
- në qoftë se ju merrni diuretik (barna që rrisin sasinë e ujit që të kalojë nëpërmjet veshkave tuaja) ose nëse jeni në dietë me kufizim të kripës që çonë në një humbje ekstreme të lëngjeve dhe të kripës në organizimin tuaj (shih pjesën 3 “Dozimi në grupe të veçanta të pacientëve”).
- nëse ju jeni të njohur të keni ngushtim apo bllokim të enëve të gjakut që çojnë në veshkat tuaj ose nëse ju keni marrë një transplantim të veshkave kohën e fundit.
- në qoftë se funksioni juaj i mëlçisë është i paaftë (shih pjesët 2 “Mos merrni Lorista” dhe 3 “Dozimi në grupe të veçanta të pacientëve”).
- në qoftë se ju vuani nga insuficienca e zemrës, me ose pa dëmtim të veshkave ose aritmi kardiakë kërcënuese për jetën. Kujdes i veçantë është i nevojshëm kur ju trajtoheni së bashku me një betablockatorë.
- në qoftë se ju keni probleme me valvulat e zemrës apo me muskujtë e zemrës.
- në qoftë se ju vuani nga sëmundjet koronare të zemrës (shkaktuar nga një rrjedhje e reduktuar e gjakut në enët e gjakut të zemrës) ose nga sëmundje cerebrovaskulare (të shkaktuara nga një qarkullimi i ulët i gjakut në tru).
- në qoftë se ju vuani nga hiperaldosteronizmi primar (një sindromi i lidhur me rritjen e sekretimit të hormonit aldosteron nga gjëndra mbiveshkore, e shkaktuar nga një anomali në gjëndër).
- nëse merrni ndonjë nga barnat në vazhdim, të cilat përdoren për trajtimin e tensionit të lartë të gjakut:
 - ACE inhibitorë (për shembull enalapril, lisinopril, ramipril), posaçërisht nëse keni probleme me veshkë që janë të lidhura me diabet.
 - aliskiren.

Nevojitet që mjeku juaj të kontrollojë funksionin e veshkave, presionin e gjakut dhe sasinë e elektrolitëve (p.sh. kaliumi) në gjakun tuaj në intervale të rregullta kohore.

Shihni edhe informacionin me titull “Mos merrni Lorista”.

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



Fëmijët dhe adoleshentët

Losartan është studiuar në fëmijë. Për më shumë informacion, bisedoni me mjekun tuaj.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barnat që merren pa recetën e mjekut.

Keni kujdes të veçantë nëse jeni duke marrë ndonjë nga barnat në vijim gjatë trajtimit me Lorista:

- barna të tjera për uljen e tensionit të gjakut pasi që ata mund gjithashtu të reduktojnë tensionin e gjakut. Tensioni i gjakut mund poashtu të ulet me një nga barnat/grupet e barnave në vijim: antidepressivët triciklik, antipsikotikët, baklofen, amifostine.
- barna të cilat mbajnë kalium ose mund të rrisin nivelet e kaliumit (p.sh. suplementet e kaliumit, kalium-zëvendësues të kripës apo barna të cilat kursejnë kaliumin të tilla si diuretike të caktuar ([amiloride, triamterene, spironolaktone] ose heparinë).
- anti-inflamator josteroidal barna të tilla si indometacin, duke përfshirë edhe inhibitorët COX-2- (barna për reduktimin e inflamimit, dhe mund që përdoren për të ndihmuar në lehtësimin e dhimbjeve), pasi ata mund të zvogëlojnë efektin e uljes së gjakut të losartanit.

Nëse funksioni i veshkave është i dëmtuar, përdorimi i njëkohshëm i këtyre barnave mund të çojë në një përkeqësim të funksionit të veshkave.

Barnat që përmbajnë litium nuk duhet të merren në kombinim me losartan pa mbikëqyrje të ngushtë nga mjeku juaj. Masat e posaçme të kujdesit (p.sh. testet e gjakut) mund të jenë të përshtatshme.

Mjeku juaj ndoshta do të duhet të ndryshojë dozën dhe/ose të ndërmarrë masa të tjera paraprake:

- nëse merrni ndonjë ACE inhibitor ose aliskiren (shikoni informacionin me titull “Mos merrni Lorista” ose “Tregoni kujdes të veçantë me Lorista”).

Marrja e Lorista me ushqim dhe pije

Lorista mund të merret me ose pa ushqim.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Nëse jeni shtatzënë, mendoni se mund të jeni shtatzënë ose planifikoni të keni bebe, kërkoni këshillë nga mjeku juaj ose farmacisti para se të merrni këtë bar.

Shtatzënia

Ju duhet të tregoni mjekut tuaj nëse ju mendoni se jeni (ose mund të bëheni) shtatzënë. Mjeku juaj normalisht do të ju këshillojë të ndërpreni marrjen e Loristës para se të mbeteni shtatzënë ose sapo të kuptoni se jeni shtatzënë dhe do të ju këshillojë të merrni një bar tjetër në vend të Loristës. Lorista nuk rekomandohet në fillim të shtatzënisë, dhe nuk duhet të merret çoftë se ju jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë, pasi ajo mund të shkaktojë dëmtime serioze për fëmijën tuaj, nëse përdoret pas muajit të tretë të shtatzënisë.

Uqyerja me gj

Tregoni mjekut tuaj nëse ju ushqeni me gj, ose nëse do të filloni të ushqyerit me gj. Lorista nuk rekomandohet për nënat që ushqejnë me gj, dhe mjeku juaj mund të zgjedh një tjetër trajtim për ju, nëse ju dëshironi të ushqyeni fëmijun me gj, veçanërisht në qoftë se fëmija juaj është i porsalindur, ose ka lindur para kohe.

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka studime mbi efektet në aftësinë për të vozitur dhe për përdorimin e makinave. Lorista nuk ka gjasa të ndikojë në aftësinë tuaj për të vozitur apo për të përdorur makineri. Megjithatë, si me barna të tjera të përdorura për trajtimin e tensionit të lartë të gjakut, losartan mund të shkaktojë marramendje ose të qenët i përgjumur te disa njerëz. Nëse ju ndodh juve të qenët i përgjumur ose marrje mendsh, ju duhet të konsultoheni me mjekun tuaj para se filloni aktivitete të tilla.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Lorista

Ky bar përmban laktozë.

Nëse ju ka thënë mjeku juaj që ju keni një intolerancë ndaj disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj para se të merrni këtë bar.

3. SI TË MERRET LORISTA

Gjithmonë merrni Lorista saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

Mjeku juaj do të vendosë mbi dozën e duhur të Loristës, në varësi të gjendjes tuaj dhe nëse ju jeni duke marrë barna të tjera. Është e rëndësishme që të vazhdoni të merrni Lorista për aq kohë sa ju ka përshkruar mjeku me qëllim për të mbajtur kontrollin e qetë të tensionit të gjakut.

Pacientët e rritur me tension të lartë të gjakut

Trajtimi zakonisht fillon me një tabletë Lorista 50 mg një herë në ditë. Maksimumi i efektit të uljes së tensionit të gjakut duhet të arrihet 3-6 javë pas fillimit të mjekimit. Në disa pacientë, doza mund të rritet më vonë në 100 mg Lorista (dy tableta Lorista 50 mg ose një tabletë Lorista 100 mg) një herë në ditë.

Nëse keni përshtypjen se efekti i losartanit është shumë e fortë ose shumë i dobët, ju lutemi bisedoni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përdorimi te fëmijët dhe adoleshentët (6 deri në 18 vjeç)

Doza e rekomanduar fillestare në pacientët që peshojnë ndërmjet 20 dhe 50 kg është 0,7 mg losartan për kg peshë trupore të përdorur një herë në ditë (deri në 25 mg Lorista). Mjeku mund të rrisë dozën nëse presioni i gjakut nuk kontrollohet.

Pacientët e rritur me tension të lartë dhe diabetit tip 2

Trajtimi zakonisht fillon me një tabletë Lorista 50 mg një herë në ditë. Doza mund të rritet më vonë në 100 mg Lorista (dy tableta Lorista 50 mg ose një tabletë Lorista 100 mg) një herë në ditë, në varësi të përgjigjes të tensionit të gjakut.

Lorista mund të administrohet me barna të tjera për uljen e tensionit të gjakut (p.sh. diuretikët kalcium beta bllokatorët, alfa ose beta bllokatorët, dhe agjentët që veprojnë në nivel qendror) si edhe me insulinë dhe barna të tjera të përdorura të cilat ulin nivelin e glukozës në gjak (p.sh. sulfonilurea, glitazone dhe frenuesit glukozidazë).

Pacientët e rritur me insuficiencë të zemrës

Trajtimi zakonisht fillon me një tabletë 12,5 mg Lorista një herë në ditë. Në përgjithësi, doza duhet të rritet varësisht nga gjendja juaj, javore, hap pas hapi (d.m.th. 12,5 mg në ditë gjatë javës së parë, 25 mg në ditë gjatë javës së dytë, 50 mg në ditë gjatë javës së tretë, 100 mg në ditë gjatë javës së katërt, 150 mg në ditë gjatë javës së pestë), deri në dozën e zakonshme mirëmbajtëse të përcaktuar nga

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



mjeku juaj. Mund të përdoret një dozë maksimale prej 150 mg losartan (për shembull, tre tableta Lorista 50 mg, ose një tabletë Lorista 100 mg dhe një tabletë Lorista 50 mg) një herë në ditë.

Në trajtimin e insuficiencës së zemrës, losartan zakonisht kombinohet me një diuretik (bar që rrit sasinë e ujit që të kalojë nëpërmjet veshkave) dhe/ose digitalis (bar që ndihmon për të bërë zemrën e fortë dhe më efikase) dhe/ose një beta bllokator.

Dozimi në grupe të veçanta të pacientëve

Mjeku mund të këshillojë një dozë të ulët, sidomos në fillimit të trajtimit, në pacientë të caktuara të tillë si ata të cilët trajtohen me diuretik në doza të larta, në pacientët me dëmtim të mëlçisë, ose në pacientët mbi moshën 75 vjeç.

Përdorimi i losartan nuk është i rekomanduar për pacientët me dëmtim të rëndë të mëlçisë (shih seksionin “Mos merrni Lorista”).

Mënyra e përdorimit

Tabletat duhet gëlltitur me një gotë ujë. Ju duhet të përpqeni për të marrë dozën e përditshme në të njëjtën kohë çdo ditë. Është e rëndësishme që ju të vazhdoni të merrni Lorista derisa mjeku juaj nuk ju udhëzon ndryshe.

Nëse merrni Lorista më shumë se ç’duhet

Nëse rastësisht keni marrë shumë tableta, ose fëmiju i ka gëlltit disa, të kontaktoni mjekun tuaj menjëherë. Simptomat e mbidozimit janë presioni i ulët i gjakut, rrahje të rritur të zemrës, e mundur edhe rrahje të ulëta të zemrës.

Nëse harroni të merrni Lorista

Mos merrni dozë të dyfishtë për ta kompensuar dozën e harruar.

Nëse aksidentalisht harroni të merrni një dozë ditore, merrni dozën e rradhës si zakonisht.

Nëse e ndërprisni marrjen e Lorista

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtoheni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Lorista mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë paraqiten ato.

Nëse përjetoni simptomat e mëposhtme, ndërpreni marrjen e Loristës dhe tregoni menjëherë mjekut tuaj ose shkoni në spitalin më të afërt:

Një reaksion alergjik i rëndë (skuqje, kruajtje, ënjtje të fytyrës, buzëve, gojës ose fytyrës që mund të shkaktojnë vështirësi në gëlltitje ose në frymëmarrje). Ky është një efekt anësorë serioz por i rrallë, që mund të ketë ndikim te 1 nga 1,000 persona). Ju mund të keni nevojë për vëmendje urgjente mjekësore ose shtrim në spital.

Efektet anësore të barnave me Lorista janë raportuar si më poshtë:

Shpesh (mund të ndikojë te 1 nga 10 persona):

PI_Text047749_1	23.03.2023 - Updated: 23.03.2023	Page 5 of 8
-----------------	----------------------------------	-------------

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



- marramendje,
- tensioni i ulët i gjakut (posaçërisht pas humbjes së tepërt të ujit nga trupi brenda enëve të gjakut, p.sh. pacientët me insuficiencë të rëndë të zemrës ose ata të cilët shërohen me doza të mëdha të diuretikëve),
- efektet ortostatike të lidhura me dozat, siç është ulja e tensionit të gjakut, i cili paraqitet kur lëviz nga pozita ulur ose shtrirë,
- dobësi,
- lodhje,
- nivel i ulët i sheqerit në gjak (hipoglikemia),
- shumë kalium në gjak (hiperkalemia),
- ndryshimet në funksionin e veshkave, përfshirë dështimin e veshkave,
- numri i reduktuar i qelizave të kuqe të gjakut (anemi),
- rritja e ureas në gjak, serum i kreatininës dhe serum i kaliumit te pacientët me dëmtim të zemrës.

Jo të zakonshme (mund të ndikojë te 1 nga 100 persona):

- përgjumje,
- dhimbje koke,
- çrregullime të gjumit,
- ndjenja e rrahjeve të shpejta ose te forta të zemrës (palpitacione),
- dhimbje të forta gjoksi (angina pectoris),
- frymëmarrje e shkurtuar (dispnea),
- dhimbje barku,
- kapsllëk i fortë,
- diarre (barkqitje),
- ndjesi e sëmundjes (mundim),
- të vjella,
- urtikarie,
- kruajtje (prurit),
- skuqje,
- ënjtje e lokalizuar (edem),
- kollë.

Të rralla (mund të ndikojë te 1 nga 1,000 persona):

- ndjeshmëri,
- angioedema,
- inflamacion i enëve të gjakut (vaskulitis) duke përfshirë gjakderdhje të lokalizuar në ekstremitetet e poshtme (Henoch-Schönlein purpura),
- mpirje apo ndjesi shpimi gjilpërash (paraesthesia),
- gjendje dobësie (të fikët),
- rrahje zemre shumë të shpejtë dhe të parregullt (dridhje atriale),
- sulm në tru (mini sulm),
- inflamacion i mëlçisë (hepatit),
- nivel i rritur i alaninë aminotransferazës në gjak (ALT), e cila zakonisht është e rikthyeshme pas ndërprerjes së trajtimit.

Të panjohura (frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave të disponueshme):

- numër i zvogëluar i trombociteve (trombocitopenia),
- migrenë,
- anomalitë e funksionit të mëlçisë,
- dhimbje në muskuj (mialgia),

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



- dhimbje në nyje (artralgia),
- simptoma të ngjashme me grip,
- dhimbje shpine,
- infeksione të traktit urinar,
- ndjeshmëri e tepruar ndaj diellit (fotosenzitiviteti),
- dhimbje e pashpjegueshme në muskuj, me ngjyrë të errët të urinës (rabdomioliza),
- pamundësi e arritjes së erekcionit për marrëdhënie seksuale të meshkujt (disfunksion erektil/impotencë),
- inflamacion i pankreasit (pankreatiti),
- nivel shumë i ulët i kaliumit në plazmën e gjakut (hiponatremia),
- depresioni,
- ndjenjë e përgjithshme e dobësisë (dobësim),
- tingëllimë, fërkëllimë ose zhurmë në vesh (tinnitus),
- ndjenjë e çrregulluar e shijes (disguzia).

Efektet e padëshirueshme të fëmijët janë të ngjashme me ato të rriturit.

Raportimi i efekteve anësore

Nëse ju paraqiten çfarëdo efekte anësore, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo nënkupton çfarëdo efekte anësore të cilat nuk janë dhënë në këtë udhëzim. Efektet anësore mund të paraqiten direkt përmes sistemit nacional për lajmërim. Me paraqitjen e efekteve anësore mund të ndihmoni në vlerësimin e sigurisë së këtij bari.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET LORISTA

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

Mos e përdorni Lorista pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Lorista 50 mg film tableta të mbështjellura:

Të ruhet në temperaturë deri në 30°C.

Ruajeni në paketim origjinal të mbrojtur nga lagështia.

Lorista 100 mg film tableta të mbështjellura:

Të ruhet në temperaturë deri në 30°C.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta mbrojtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Lorista

-Supstanca aktive është losartan kaliumi.

1 film tabletë e mbështjellur përmban 50 mg ose 100 mg losartan kaliumi.

1.3.1	Losartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



-Përbërësit e tjerë të tabletave 50 mg dhe 100 mg janë: amidon misri, amidon i prexhelatinizuar, celulozë mikrokristaline (E460), silika koloidale anhidër (E551), stearat magnezi (E470b), pluhur celuloze (E460) dhe monohidrat laktoze në bërthamën e tabletës dhe hipromelozë (E464), talk (E553b), propilen glikol (E1520) dhe dioksid titani (E171) në film mbështjellës.

Shih seksionin 2 “Lorista përmban laktozë”.

Si duket Lorista dhe përbërja e paketimit

Lorista 50 mg film tabletat e mbështjellura janë të rumbullakta, pak bikonvekse, të bardha me skaje të thyera dhe të shënuara në njërin anë. Linja e ndarjes nuk është e destinuar për ndarje të tabletës. Tabletata gjenden në kuti me 28 (2x14) film tableta të mbështjellura në blistera.

Lorista 100 mg film tabletat e mbështjellura janë ovale, pak bikonvekse, të bardha. Tabletata gjenden në kuti me 28 (2x14) film tableta të mbështjellura në blistera.

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet me recetë të mjekut.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

Prodhuesi

- Lorista 50 mg dhe 100 mg film tableta të mbështjellura:

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

- Lorista 50 mg film tableta të mbështjellura:

TAD Pharma GmbH, Heinz-Lohmann Straße 5, 27472 Cuxhaven, Gjermani

tel: +386 7 331 28 84,

fax: +386 7 332 27 42

www.krka.si

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në

Mars, 2023.